



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2497/ 16 Prot.

Datë 04/12/2025

V E N D I M
Nr. 1791/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/12/2025 mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1667/2025, datë 13.11.2025 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*” me fond limit 12,583,334 (*dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

Operatori Ekonomik “*Euro Mega 2010*” SHPK, me NUIS K91624505A, me adresë: *Fshati Ahemtaq, prane firmës Ital Kon, Prezë, Tiranë.*

Operatori Ekonomik “*Malvina Visoka*” PF, me NUIS L61608005C, me adresë: *Rruga “Muhamet Veliu”, Pallati 3D, Njesia me Nr. Pasurie 475/103-G15, ZK. 2460, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” Nr. 492, Kamëz, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

Operatori Ekonomik “Anbim” SHPK me NUIS L81618008J, me adresë: *Autostrada Tr-Dr Km 1, Zona kadastrale 2679 Numri pasurise 40/55, Tiranë.*

Operatori Ekonomik “Besim Kamberi” PF, me NUIS L42103023G, me adresë: *Magazinat e Buka sha, Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20 Kashar, Tiranë.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datën 13.11.2025 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 1667/2025 ka vendosur:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “Blerje mjete pastrimi” me fond limit 12,583,334 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “Blerje mjete pastrimi” me fond limit 12,583,334 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e

tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

3. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Anbim” SHPK dhe “Euro Mega 2010” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet duke i skualifikuar ato.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Malvina Visoka” PF.*
6. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 10231/1 prot, datë 21.11.2025, shkresën nr. 10352/1 prot, datë 25.11.2025 dhe shkresën nr. 10449 prot, datë 26.11.2025, të protokolluara përkatësisht me tonat me nr. 2497/11, datë 27.11.2025, me nr. 2497/12 prot, datë 02.12.2025 dhe nr. 2497/13 prot., datë 03.12.2025, autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1667/2025 datë 13.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*” me fond limit 12,583,334 (*dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 10231/1 prot, datë 21.11.2025, shkresën nr. 10352/1 prot, datë 25.11.2025 dhe shkresën nr. 10449 prot, datë 26.11.2025, të protokolluara përkatësisht me tonat me nr. 2497/11, datë 27.11.2025, me nr. 2497/12 prot, datë 02.12.2025 dhe nr. 2497/13 prot., datë 03.12.2025, autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1667/2025 datë 13.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “*Blerje mjete pastrimi*” me fond limit 12,583,334 (*dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vërehet se, autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresave të mësipërcituara ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1667/2025

datë 13.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës, duke skualifikuar operatorin ekonomik “Anbim” SHPK, si dhe duke skualifikuar operatorin ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK në këtë procedurë prokurimi. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP Nr. 1667/2025 datë 13.11.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 46 pika 2 e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-51165-06-13-2025 me objekt “Blerje mjete pastrimi” me fond limit 12,583,334 (dymbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 22.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

